



Prishtinë: 17.06.2011

Kodi i ZRRE-së: V_369_2011

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_569_04_11

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_569_04_11**;

Në mbledhjen e mbajtur më 17 qershor 2011 nxori këtë:

VENDIM

APROVOHET ankesa e konsumatorit Mentor Rexhepi, konsumatori komercial (shifra DPR – 90024463), nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të 07.05.2008 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 07.04.2008 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 22.10.2007 kanë inspektuar pikën te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrike nr. 1069185 dhe kanë vendosur njehsorin elektrik nr. 12457298.
Provë: Vërtetimi mbi heqjen dhe ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 1493 të datës 22.10.2007
- Punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit me datë 07.11.2007 kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 1069185 dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik vulat shtetërore i ka të manipuluar si dhe numëruesi i manipuluar.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 1/7 i datës 07.11.2007
- Punëtorët e qendrës së kalibrimit në periudhën 11/2007 kanë bërë shqyrtimin e njehsorit elektrike ku kanë konstatuar se njehsori elektrik nuk është brenda kufijve në matjen e energjisë elektrike.
Provë: Protokoli mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 5426
- Punëtorët e autorizuar të KEK me datë 12.02.2008 kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse.
Provë: Procesverbali nr. 0126875 i datës 12.02.2008
- Me datë 29.02.2008 KEK-u e ngarkon konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR08HP04842 në vlerë prej 8154.42 €.
Provë: Fatura e KEK-ut DPR08HP04842 e datës 29.02.2008



- Me datë 31.03.2008 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 07.04.2008 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalin e kontrollës.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 07.04.2008
- Me datë 23.03.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 08.12.2009 DMK në pajtim me paragrafin 14.3 të nenit 14 të Rregullit mbi Procedurën për Zgjidhjen e Kontesteve në Sektorin e Energjisë, ka analizuar ankesat e konsumatorëve dhe ka vlerësuar se zyrtarët e autorizuar për inspektimin e pikave matëse gjatë përpilimit të procesverbaleve nuk kanë shënuar shumat e fuqive të shpenzuesve të inventarizuara me rastin e inspektimit të pikave matëse tek konsumatorët komercial dhe industrial ka kthyer në rishqyrtim lëndën e konsumatorit. Sipas kësaj KEK-u ka vepruar në kundërshtim me Nenin 12 të Procedurës së Përkohshme për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar.
Provë: Dokumenti i DMK për rishqyrtimin e ankesave të konsumatorëve
- Me datë 21.05.2010 Komisioni i KEK-ut në përbërje të stafit përgjegjës të operatorit të rrjetit dhe furnizuesit publik, ka refuzuar prapë ankesën e konsumatorit.
Provë: Vendimi i Komisionit të KEK-ut të datës 21.05.2010

DMK, duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ Pasi që DMK e ka dërguar lëndën e konsumatorit në rishqyrtim në KEK, punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me datë 05.02.2010 dhe kanë konstatuar se lokali i konsumatorit nuk punon dhe se nuk ka pajisje.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 395918 të datës 05.02.2010
- ✓ KEK-u pas inspektimit të pikës matëse të cilat i ka evidentuar në procesverbalin nr. 395918 të datës 05.02.2010, kanë bërë edhe llogaritjen e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Sipas llogaritjeve të bëra nga KEK-u rillogaritja e ngarkesës për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike del me vlerë 540.25 €.
Provë: Llogaritja e KEK-ut për shfrytëzim të paautorizuar
- ✓ Komisioni i KEK-ut pasi ka marrë lëndën e konsumatorit në rishqyrtim, ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe ka refuzuar ankesën e konsumatorit në arsyetimin se: *“konsumatorit njehsori nr. 1069185 sipas procesverbalit nr. 1493 i është ndërruar me dt. 22.10.2007. Ky njehsor është dërguar në shërbimin e kalibrimit dhe me dt. 07.11.2007 është përgatitur procesverbali i kontrollimit detal nr. 1/7 sipas të cilit: njehsori pllombat shtetërore i ka të manipuluar, numëruesi kthyer mbrapa (i manipuluar). Poashtu edhe sipas procesverbalit të shqyrtimit të njehsorit konfirmohet se njehsori se nuk është brenda kufijve të lejuar. Në bazë të këtij procesverbali shërbimi i faturimit ka llogaritur faturën interne duke u bazuar në kabllin furnizues 4x6 mm/2. Sipas kësaj edhe me dt. 29.02.2008 ka rezultuar fatura e RH në*



vlerë 3,684.88 €. Vërejtje: Fatura interne në bazë të cilit llogaritet fatura e RH, sipas Proc. Perk. Për idenë. Dhe paran. Duhet të bazohet në pajisjet të pajisjet të cilat i furnizon pika matëse e jo në siguresa siç është llogaritur RH. Njehsori është prodhim i viti 1972. Shpenzimi mesatar i energjisë që është regjistruar në periudhën e RH është 503 KW, në periudhën para RH është 658 kWh dhe pas RH është 88 kW. Rillogaritja e RH me pajisje nuk mund të bëhet pasi lokali nuk punon dhe nuk ka asnjë pajisje prandaj është bërë sipas procesverbalit të pranimit të instalimit elektrik e që rezulton në vlerë 540.25€. Vendimi i komisionit: Dënimi meritor”.

Provë: Vendimi i Komisionit të KEK-ut të datës 05.05.2010

- ✓ Komisioni i KEK-ut në vendimin e tyre pas rishqyrtimit të lëndës së konsumatorit ka refuzuar ankesën e konsumatorit në arsyetimin se: në bazë të fakteve të procesverbalit 1/7 dt. 07.11.2007 dhe sipas parametrave të paraqitura në procesverbalin nr. 0126875 dt. 12.02.2008 konstatojmë se fatura nr. DPR08HP04842 dt. 29.02.2008 në vlerë 8,154.42 € është llogaritur konform nenit 12 të procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Rillogaritja e RH sipas procesverbalit të kontrollës nr. 3955918 dt. 05.02.2010, rezulton në vlerë 540.25 €. Por pasi evidentimi i këtyre pajisjeve është bërë në një periudhë tjetër nga periudha e rikthimit të humbjeve, komisioni qëndron pas vendimit të ekzistues.
Provë: Vendimi i Komisionit të KEK-ut të datës 21.05.2010
- ✓ KEK-u edhe përkundër asaj që DMK ka kthyer në rishqyrtim ankesën e konsumatorit dhe i ka konstatuar se KEK nuk ka vepruar sipas nenit 12 të procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, KEK-u prapë ka refuzuar ankesën e konsumatorit, duke mos e marrë për bazë shkeljen e procedurës.
- ✓ Punëtorët e KEK-ut me datë 09.07.2001 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë bërë pranimin e instalimit njehsorit elektrik të konsumatorit.
Provë: procesi i pranimit
- ✓ Njehsori elektrik i konsumatorit është prodhim i vitit 1972 dhe se nuk dihet data e montimit të këtij njehsori dhe nuk ka asnjë se i është bërë më parë kontrollimi teknik (kalibrimi) këtij njehsori.
- ✓ Sipas rrjedhës së energjisë aktive mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike sipas viteve ka qenë: 2005 – 904 kWh/muaj; 2006 – 754 kWh/muaj; 2007 – 126 kWh/muaj; 2008 – 92 kWh/muaj; 2009 – 4 kWh/muaj. Sipas rrjedhës së energjisë aktive vërehet se mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsor të ri ka pësuar rënie në krahasim me mesataren e shpenzimit me njehsor të vjetër: 12 muaj para se të ndërrohet njehsori elektrik mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike ka qenë 247 kWh/muaj (regjistruar në njehsorin e vjetër); 12 muaj pas ndërrimit të njehsorit elektrik mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike ka qenë 109 kWh/muaj (regjistruar në njehsorin e ri).
Provë: Rrjedha e energjisë aktive
- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike në sezonën dimërore me njehsor elektrik të vjetër nr. 1069185 për periudhën 11/2006 – 03/2007 ka qenë 565 kWh/muaj, për periudhën 11/2005 – 03/2006 ka qenë 851 kWh/muaj, ndërsa mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsor të ri nr. 12457298 për periudhën 11/2007 – 03/2008 ka qenë 176



kWh/muaj.

Provë: Rrjedha e energjisë aktive

- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike në sezonën ri me njehsor elektrik të vjetër nr. 1069185 për periudhën 04/2006 – 09/2006 ka qenë 782 kWh/muaj, për periudhën 04/2005 – 09/2006 ka qenë 851 kWh/muaj, ndërsa mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsor të ri nr. 12457298 për periudhën 04/2008 – 09/2008 ka qenë 55 kWh/muaj.
Provë: Rrjedha e energjisë aktive
- ✓ Sipas deklaratës së konsumatorit theksohet se njehsori elektrik ka regjistruar më shpejtë dhe se disa herë ka lajmëruar KEK-un se nuk është në rregull. Konsumatori ka theksuar se punëtorët e KEK-ut i kanë theksuar se dikush është i kyçur në njehsorin e tyre. Prej muajit mars 2007 e deri te ne tetor 2007 lokali ka qenë i mbyllur. Njehsori elektrik ka regjistruar energji elektrike edhe përkundër që lokali ka qenë mbyllur dhe se pas kësaj kam kërkuar që të bëhet ndërrimi njehsorit elektrik. Pas ndërrimit të njehsorit ka ndodhur që jam ngarkuar nga ana e KEK-ut me faturë prej 8400 €.
Provë: Ankesa e konsumatorit
- ✓ KEK-u nuk ka respektuar saktë nenin 12 të Procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, pasi që ka ngarkuar konsumatorin me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike duke llogaritur me profil të kabllit furnizues, e që në fakt është dashur t'i merren pajisjet elektrike në lokal.
- ✓ KEK-u në rastin e konsumatorit nuk ka bërë asnjë analizë të lëndës së konsumatorit, rrjedhës së energjisë aktive dhe procesverbaleve të KEK-ut por konsumatorin e kanë ngarkuar vetëm sipas konstatimeve teknike të bëra në laboratorin e kalibrimit.

DMK, duke u bazuar në analizat dhe argumentet e paraqitura më lartë, rekomandon Bordin e ZRRE-së, që të **aprovoj** ankesën e konsumatorit dhe të obligon KEK-un që:

- Të shkarkojë konsumatorin me shifër DPR – 90024463 nga ngarkesa e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike fatura DPR08HP04842 e datës 29.02.2008 në vlerë prej 8154.42 €

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet dhe argumentet e paraqitura dhe pas analizës së lëndës së konsumatorit ka vendosur që të **aprovon** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

- Të shkarkojë konsumatorin me shifër DPR – 90024463 nga ngarkesa e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike fatura DPR08HP04842 e datës 29.02.2008 në vlerë prej 8154.42 €



Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar